UNIONE ARBERIA
LIDHJA ARBËRIA

MENSILE BILINGUE DI INFORMAZIONE - ANNO II - N. 8 - LUGLIO 2010

GAZETË E PËRMUAJSHME NJOFTIMI DYGJUHËSHE - VITI II-Nr. 8 - LLONAR 2010

DIFFUSIONE GRATUITA / *SHPRISHJE E LIRË*

NEWS

IN QUESTO NUMERO / *TE KY NUMËR:*

- **Legge 15 dicembre 1999, n. 482 (Artt. 17-18-bis) / *Ligji 15 dhjetor 1999, nr. 482 (Nenet 17-18-bis)*** **p. 1**
- **S. DEMETRIO C. Presentato libro di Brunetti /** *SHËN MITËR. U paraqit vëllimi i Mario-s Brunetti* **p. 2**
- **S. DEMETRIO C. Una tesi di laurea sulla ricostruzione storica della biblioteca di Sant'Adriano / *SHËN MITËR. Një punë diplome universiteti mbi rindërtimin historik të bibliotekës së Shën Adrianit*** **p. 2**
- **ARBERIA. Consegnate Borse di Studio in memoria di p. F. Solano / *ARBËRI. I dhanë Bursat Studimi për kujtim të z. F. Solano*** **p. 2**
- **S. DEMETRIO C. Riqualificazione urbanistica di P.zza del Popolo / *SHËN MITËR. Kualifikimi urbanistik të Sheshit të Popullit*** **p. 3**
- **S. SOFIA D'E. "*In viaggio con il libro… per una nuova avventura*" / *SHËN SOFI. "Në udhëtim me librin… për një aventurë të re"*** **p. 3**
- **VACCARIZZO A. Premiato tra i ricicloni da Legambiente / *VAKARIC. E pati çmimin për riqarkullimin ka* Legambiente** **p. 3**
- **VACCARIZZO A. "Le minoranze etniche religiose e l'Unità d'Italia"/VA*KARIC. "Pakicat etnike fetare dhe Bashkimi i Italisë "*** **p. 4**
- **S. DEMETRIO C. Operatori ex fondo sollievo ad Acri / *SHËN MITËR. Operatorët e ish Fondit Lehtësimi Akër*** **p. 4**
- **S. GIORGIO A. "S. Giorgio e i suoi Comuni" / *MBUZAT. "Shën Gjergji dhe Bashkitë të tij"*** **p. 4**
- **S. DEMETRIO C. Inaugurata immagine di Madre Teresa di Calcutta / *SHËN MITËR. U përurua piktura e Nënë Terezës*** **p. 4**
- **S. SOFIA D'E. Incontro UNICEF / *SHËN SOFI. Takimi me shoqatën* UNICEF** **p. 5**
- **S. DEMETRIO C. La Cina protagonista di una mostra / *SHËN MITËR. Kina protagoniste e një pamjeje*** **p. 5**
- **S. COSMO A. Il Coro ad Olevano sul Tusciano / *STRIGAR. Kori në Olevano sul Tusciano*** **p. 5**
- **S. SOFIA D'E. Festeggiamenti in onore di Santa Venere / *SHËN SOFI. Festimet për Shënjtjen Vener*** **p. 5**
- **S. DEMETRIO C. XXIX Festival della Canzone Arbëreshe / *SHËN MITËR. Organizimi i XXIX i Festivalit të Këngës Arbëreshe*** **p. 6**
- **S. DEMETRIO C. Quarto Grand Prix di San Demetrio / *SHËN MITËR.* Grand Prix *i Katërt i Shën Mitrit*** **p. 6**
- **L'estate nei paesi dell'Unione "Arberia" / *Vera e katundevet të Lidhjes "Arbëria"*** **p. 6**
- **Cultura italo-albanese e tradizione popolare / *Kultura arbëreshe dhe tradita popullore: Kangjelet për Shën Mërinë e Karmënit dhe Shënjtjen Vener*** **p. 7**
- **ARBERIA. Maria Credidio presenta la sua nuova scultura / *ARBËRIA. Maria Credidio paraqet skulpturën e saj të re*** **p. 8**
- **S. DEMETRIO C. Una rossanese per Miss Valle Crati / *SHËN MITËR. Një vashëz ka Rusana për* Miss Valle Crati** **p. 8**
- **S. DEMETRIO C. In pensione il più anziano del Comune / *SHËN MITËR. Në pension më i madhi i Bashkisë së Shën Mitrit*** **p. 8**
- **S. DEMETRIO C. Cosimo Bellucci Osservatore Arbitrale CAI / *SHËN MITËR. Cosimo Bellucci Vëzhgues Arbitror te* CAI** **p. 8**

LEGGE 15 DICEMBRE 1999, N. 482 (Artt. 17-18-bis)
"Norme in materia di tutela delle minoranze linguistiche storiche"
(Testo approvato in via definitiva dal Senato della Repubblica Il 25 novembre 1999; pubblicato sulla G.U. del 20.12.1999)

(*continua dal num. 7-Giugno 2010*)

Art. 17

1. Le norme regolamentari di attuazione della presente legge sono adottate entro sei mesi dalla data di entrata in vigore della medesima, sentite le regioni interessate.

Art. 18

1. Nelle regioni a statuto speciale l'applicazione delle disposizioni più favorevoli previste dalla presente legge è disciplinata con norme di attuazione dei rispettivi statuti. Restano ferme le norme di tutela esistenti nelle medesime regioni a statuto speciale e nelle province autonome di Trento e di Bolzano.

2. Fino all'entrata in vigore delle norme di attuazione di cui al comma 1, nelle regioni a statuto speciale il cui ordinamento non preveda norme di tutela si applicano le disposizioni di cui alla presente legge.

Art. 18-bis

(art. aggiuntivo introdotto dall'art. 23, legge 23 febbraio 2001, n. 38)

1. Le disposizioni di cui all'articolo 3 della legge 13 ottobre 1975, n. 654, e successive modificazioni, ed al decreto legge 26 aprile 1993, n. 122, convertito, con modificazioni, dalla legge 25 giugno 1993, n. 205, si applicano anche ai fini di prevenzione e di repressione dei fenomeni d'intolleranza e di violenza nei confronti degli appartenenti alle minoranze linguistiche.

LIGJI I DATËS 15 DHJETOR 1999, NR. 482 (Nenet 17-18-bis)
"Normat në lidhje me mbrojtjen e pakicavet gjuhësore historike"
(Teksti i miratuar në formë përfundimtare nga Senati i Republikës, më 25 nëntor 1999; i botuar në G.Z. të datës 15.12.1999)

(vazdhon ka numri 7-Theristi 2010)

Neni 17

1. Normat rregulluese për zbatimin e këtij ligji adaptohen brenda gjashtë mujave nga data e hyrjes në fuqi të tij, duke i dëgjuar edhe krahinat përkatëse.

Neni 18

1. Në krahinat me statut të veçantë, zbatimi i dispozitave më të favorshme të parashikuar nga ky ligj rregullohet me normat për zbatimin e statuteve përkatëse. Mbeten të pandryshuara normat e tutelës që ekzistojnë në të njëjtat krahina me statut të veçantë dhe në provinçat autonome të Trentit dhe Bollxanit.

2. Deri në hyrjen në fuqi të normave të zbatimit, të cilat përfshihen në paragrafin 1, në krahinat me statut të veçantë, ku legjislacioni i të cilave nuk parashikon norma të tutelës, zbatohen dispozitat e pranishme në këtë ligj.

Neni 18-bis

(nen plotësues i futur nga neni 23, ligji 23 fjavar 2001, nr. 38)

1. Dispozitat për të cilat flasin neni 3 i ligjit 13 tetor 1975, nr. 654, dhe ndryshime pasuese, dhe dekretligji 26 prill 1993, nr. 122, i shndërruar, me ndryshime, nga ligji 25 qershor 1993, nr. 205, zbatohen edhe me qëllimin parandalimi dhe shtypjeje të dukurive intolerance dhe egërsie ndaj anëtarëve të pakicavet gjuhësore.

SAN DEMETRIO CORONE
Presentato libro di Brunetti

"Le cose del mondo. Narrazione di un itinerario internazionale". È il titolo del libro, scritto da Mario Brunetti, di Plataci, presentato la sera di lunedì 5 luglio nella sala consiliare del comune di San Demetrio Corone. Nel volume, edito da Rubbettino, Brunetti traccia un percorso che parte dalla prima Guerra del Golfo sino ad arrivare all'attacco terroristico alle Torri Gemelle di New York. Sono inoltre narrate le tragiche vicende della Somalia, collegate alle rotte del traffico delle armi e delle scorie radioattive che portarono all'uccisione di Ilaria Alpi e Miran Hrovatin. Sono anche riportati verbali e documenti che, per il loro contenuto, danno un valore aggiunto al testo. Alla presentazione del libro sono intervenuti, oltre all'autore Mario Brunetti, il sindaco di San Demetrio, Antonio Sposato, l'assessore Mimmo De Paola, il professore Gianni Mazzei e il professore di lingua e storia italiana dell'università di Rodhe Island, Michelangelo la Luna, accompagnato dagli studenti americani, da due mesi nel paese arbëresh per un periodo di studi e approfondimenti della lingua italiana, della storia e del cinema.

SAN DEMETRIO CORONE
Una tesi di laurea sulla ricostruzione storica della biblioteca di Sant'Adriano

La ricostruzione storica della biblioteca del Collegio di Sant'Adriano, di San Demetrio Corone, al centro della tesi di laurea discussa da un universitario sandemetrese, Natale Vacalebre, i primi di luglio all'Università di Perugia. Il lavoro del giovane universitario ha raggiunto due obiettivi: da una parte far conoscere anche fuori dai confini della Calabria il notevole patrimonio bibliografico dell'ente sandemetrese, tramite la pubblicazione in digitale di un antico catalogo della biblioteca datato 1913; dall'altra proporre una ricostruzione storica della biblioteca stessa, principalmente per ciò che riguarda il suo rapporto con l'istituzione di appartenenza, dal periodo dell'antico seminario Corsini di San Benedetto Ullano fino alla separazione definitiva del Liceo dal convitto (1923). La tesi è stata approvata con 110 e lode e menzione augurale di elevazione alla dignità di stampa, il che significa che la commissione esaminatrice ha augurato ufficialmente al laureato di pubblicarla in modo di farla conoscere a un pubblico più vasto. A Natale Vacalebre sono giunti gli auguri e il plauso del Presidente del Collegio di Sant'Adriano, On. Cesare Marini che si è impegnato a provvedere alla diffusione del lavoro da lui svolto.

ARBERIA
Consegnate Borse di Studio in memoria di papàs Francesco Solano

Sono state consegnate lunedì 12 luglio, presso la Sala University Club dell'Unical, le tre borse di studio, istituite dalla sezione di Albanologia, dipartimento di Linguistica, e intitolate alla memoria di papàs Francesco Solano (1914-1999), originario di Frascineto, fondatore e titolare della Cattedra di Lingua e Letteratura Albanese dell'Università della Calabria. Questi i vincitori: il dr. Luigi Genise di Lungro, che ha presentato la tesi di laurea dal titolo "*Krështeu i shëjteruor* di F. A. Santori: edizione critica e traduzione italiana"; la dr.ssa Sandra Domanico di Cerzeto, con una con una tesi su "Le favole tradotte in albanese da F. A. Santori: introduzione, trascrizione e traduzione"; la dr.ssa Adriana Ponte, operatrice dello Sportello linguistico dell'Unione Arberia, che ha presentato la tesi di laurea dal titolo "*Le storie d'Albania* di Girolamo De Rada, parte seconda. Edizione critica e concordanza elettronica del testo"; tutti e tre laureati in Lingue e Letterature Straniere presso l'Unical, con tesi di laurea in Filologia Albanese. La graduatoria ha tenuto conto del voto di laurea, del lavoro di tesi e del curriculum degli studi. Alla cerimonia di consegna delle borse di studio, consistenti in 1000,00 euro ciascuna, sono intervenuti: il prof. Francesco Altimari, ordinario della Cattedra di Lingua e Letteratura Albanese; il prof. Raffaele Perrelli, Decano della Facoltà di Lettere e Filosofia; la dr.ssa Fiorella De Rosa, ricercatrice; presenti anche Maria Francesca Corigliano, Assessore alle Minoranze linguistiche dell'Amministrazione Provinciale di Cosenza e Mario Bova, *(segue a pag. 3)*

SHËN MITËR
U paraqit vëllimi i Mario-s Brunetti

"Gjërat e dheut. Tregim i një itinerari ndërkombëtar". Është ky titulli i vëllimit, të shkruar ka Mario Brunetti, ka Pllatëni, të paraqitur të hënën 5 llonar tek salla këshilltare e Bashkisë së Shën Mitrit. Tek vëllimi, i botuar ka Rubbettino*, Brunetti përvijoi një rrugë çë niset ka Lufta e Gjirit të detit njera te sulmi terrorist të Kullavet Binjake të Nju-Yorkut. Rrëfyehen edhe ngjarjet tragjike e Somalisë, të lidhura me tregtimin e armavet dhe të skorievet radioative çë vranë Ilarjen Alpi dhe Miran Hrovatin. Çohen këtu edhe verbale dhe dokumente, çë me përmbajtjen e tyre, ia japen një vlerë më të madhe vëllimit. Tek paraqitja e vëllimit muartin pjesë, përveç autorit Mario Brunetti, kryetari i Shën Mitrit, Antonio Sposato, asesori Mimmo De Paola, profesori Gianni Mazzei dhe profesori i gjuhës dhe të historisë italiane të Universitetit të* Rodhe Island*, Michelangelo La Luna, i bashkuar ka studentët amerikanë, çë ka dy muaj janë te katundi arbëresh për studime dhe thellimin e gjuhës italiane, të historisë dhe të kinematografisë.*

SHËN MITËR
Një punë diplome universiteti mbi rindërtimin historik të bibliotekës së Shën Adrianit

Rindërtimi historik i bibliotekës së Kullexhit të Shën Adrianit, Shën Mitër, në qendër të punës diplome të diskutuar ka një universitar shënmitrot, Natale Vacalebre, të parët ditë e llonarit tek Universiteti të Peruxhies. Puna e universitarit të ri ia arriti dy pikësynimeve: ka nj'anë ai sa të bën të njihet edhe jashtë ka kufijtë e Kalabrisë pasuria bibliografike me vlerë e entit shënmitrot, për ndjetë botimit me format digjital të një katalogu të moçëm të bibliotekës të vitit 1913; ka jetr'anë ai sa të propozohet një rindërtim historik të së njëjtës bibliotekë, mbi të gjitha për sa i takon marrëdhënievet të saj me institutin tek i cili bën pjesë, çë ka periudha e seminarit të lashtë Corsini *të Shën Benedhitit njera tek ndarja përfundimtare e Liçeut ka konvikti (1923). Puna diplome u miratua me notë të shkëlqyeshme dhe përmendje urimi çë të emërohet tek posti i lartë i shtypjes, e kjo do të thotë se komisioni provimi ia uroi zyrtarisht të diplomuarit sa t'e botonjë atë kështu çë mund të bën të njihet ka një publik më i gjerë. Natalit Vacalebre i arritin përgëzimet dhe pëlqimi i Presidentit të Kullexhit të Shën Adrianit, i Nderuari Cesare Marini çë e muari zotimin sa të bën të shprishet puna e zhvilluar.*

ARBËRI
I dorëzuan Bursat Studimi për kujtim të zotit F. Solano



I dorëzuan të hënën 12 llonar, tek Salla University Club *të Universitetit të Kalabrisë, tri bursat studimi, të caktuara ka dega e Albanologjisë, departamenti i Gjuhësisë, dhe të kushtuara kujtimit të zotit Francesco Solano (1914-1999), me origjinë ka Frasnita, themelues dhe profesor i parë i rregullt i Katedrës së Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe të Universitetit të Kalabrisë. Këta fituesit: dok. Luigi Genise ka Ungra, çë e paraqiti punën diplome universiteti me titull "*Krështeu i shëjteruor *ka F. A. Santori: botim kritik dhe përkthim italisht"; dok.sha Sandra Domanico ka Qana, me një punë mbi "Përrallëzat e përkthyer shqip ka F. A. Santori: hyrje, transkriptim dhe përkthim"; dhe dok.sha Adriana Ponte, operatore e Sportelit gjuhësor të Lidhjes Arbëria, çë e paraqiti punën me titull "*Rrëfimet e Arbërit *ka J. De Rada, pjesa e dytë. Botim kritik dhe përkim elektronik i tekstit"; të tre të diplomuar për Gjuhë dhe Letërsi të Huaj tek Universiteti i Kalabrisë, me punë diplome mbi Studimet Filologjike Shqiptare. Klasifikimi i muari parasysh notën e diplomës, punën diplome dhe karrierën e studimevet. Tek ceremonia e dhënies së bursavet studimi, çë përbëheshin ka 1000,00 € nganjë, muartin pjesë: prof. Francesco Altimari, profesor efektiv i Katedrës së Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe; prof. Raffaele Perrelli, Dekan i Fakultetit të Letërsisë dhe Filozofisë; dok.sha Fiorella De Rosa,* (vazhdon tek faqja e 3të)

(segue da pag. 2)

Direttore Generale del Ministero degli Affari Esteri per i Paesi Europei, in quanto la premiazione si è svolta nel corso della serata di inaugurazione delle Scuole Estive Internazionali di Italiano (SEII), di Albanistica e Balcanistica (SEIAB), organizzate dal Dipartimento di Linguistica dell'Università della Calabria, nell'ambito del progetto VATRA, per il dialogo interculturale tra Italia e Balcani.

SAN DEMETRIO CORONE
Avviati i lavori di riqualificazione urbanistica di Piazza del Popolo

Sono stati avviati dall'Amministrazione comunale di S. Demetrio C. i lavori di riqualificazione urbanistica di piazza del Popolo. Il quartiere popolare sorto nei primi anni Settanta a nord del centro cittadino versava da tempo in cattive condizioni urbanistiche; per questo motivo, nel mese di maggio 2007, l'amministrazione comunale di S. Demetrio aveva indetto un concorso di idee per il recupero della piazza. Vincitore del concorso era risultato l'Architetto Demetrio Loricchio al quale sono stati affidati il progetto esecutivo e la direzione dei lavori. L'opera, che dovrà concludersi entro i primi del mese di ottobre 2010, è stata finanziata dalla Regione Calabria (fondi della Cassa Depositi e Prestiti). La somma a disposizione per la realizzazione dei lavori ammonta a 103.510,82 euro, al netto del ribasso d'asta pari al 28,051% praticato dall'impresa "Miracco G." di S. Sofia d'E. Il recupero riguarderà il ripristino del verde antistante le abitazioni, la creazione di percorsi pedonali, la pavimentazione di tutta la piazza e la realizzazione dell'impianto di illuminazione esterno a sostituzione di quello esistente oramai obsoleto. È inoltre prevista la realizzazione di un'area parcheggio con alcuni posti riservati ai disabili; la messa in opera di panchine in legno e metallo e di cestini per i rifiuti. Il traffico all'interno della piazza verrà limitato ai soli veicoli che non superano una certa portata, al fine di preservare la pavimentazione in pietra molto pregiata costituita da granito estratto da una cava sita in un comune limitrofo a quello di S. Demetrio.

SANTA SOFIA D'EPIRO
"*In viaggio con il libro… per una nuova avventura*"

Sabato 3 luglio, presso la Biblioteca Civica "A. Masci", l'Amministrazione comunale di Santa Sofia d'Epiro ha organizzato un evento per promuovere l'importanza ed il piacere della lettura, rivolto ai ragazzi della scuola primaria, dal titolo "In viaggio con il libro… per una nuova avventura". Il progetto ha avuto come scopo principale la promozione del piacere della lettura e il recupero del "gusto" per la parola letta ad alta voce, proponendosi anche di presentare un'immagine nuova di biblioteca quale luogo accessibile a tutti, fonte di stimoli, accogliente e divertente. Il percorso è stato articolato in due incontri (al mattino e al pomeriggio) nei quali i ragazzi, in base all'interesse espresso, sono stati coinvolti in varie attività: ricerca e consultazione, cioè attività in grado di fornire strumenti che permettano l'individuazione di criteri utili nella ricerca e consultazione di materiale bibliografico; atelier di letture, cioè attività di gruppo su letture in grado di creare momenti di discussione, analisi e riflessione; laboratori, cioè spazi di lavoro su specifici temi incontrati nelle letture, opportunamente individuate con il gruppo partecipante, in modo da sviluppare momenti di interazione, attività creative e condivisione di un percorso.

VACCARIZZO ALBANESE
Comuni: Vaccarizzo A. premiato tra i ricicloni da Legambiente

Il Comune di Vaccarizzo A. è stato premiato al concorso "Comuni Ricicloni 2010", grazie ai risultati conseguiti nella raccolta differenziata, che nell'anno 2009 ha raggiunto la percentuale del 66%. A ritirare il premio è stato, a Roma, il sindaco del comune arbëresh, Aldo Marino. L'evento è stato organizzato da Ecosportello Rifiuti, lo sportello informativo di Legambiente per le pubbliche amministrazioni sulle raccolte differenziate, con il patrocinio del Ministero dell'Ambiente e la Tutela del Territorio e del Mare. L'amministrazione comunale del centro di origine albanese da un paio di anni ha avviato un percorso sulla base di quanto richiesto dalle norme europee. Per entrare nelle graduatorie dei "Comuni ricicloni" era necessario superare il 50% di raccolta differenziata.

(vazhdon ka faqja e 2të)

*kërkimtare; ishin edhe M. F. Corigliano, Asesor për Pakicat gjuhësore të Administratës Provincal të Kosenxës, dhe M. Bova, Drejtor i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëvet të Jashtme për Shtetet Europiane, sepse dhënia e çmimevet u mba gjatë mbrëmjes përurimi të Skollavet Verore Ndërkombëtare Italishtjeje (*SEII*), Albanistike dhe Balkanistike (*SEIAB*), të organizuara ka Departamenti i Gjuhësisë së Universitetit të Kalabrisë mbrënda projektit* VATRA*, për dialogun ndërkulturor midis Italisë dhe Ballkanit.*

SHËN MITËR
U nistin punët kualifikimi urbanistik të mëtejshëm të Sheshit të Popullit

Administrata e Bashkisë së Shën Mitrit i nisi punët kualifikimi urbanistik të mëtejshëm të Sheshit të Popullit. Lagja popullore e lerë tek fillimi i vitevet Shtatëdhjetë tek ana veriore e katundit kish shumë mot çë gjendej në kushte urbanistike të keqe; për këtë arsye, tek muaji i majit 2007, administrata bashkiake e Shën Mitrit kish shpallur një konkurs idesh për rifitimin e sheshit. Fitues i konkursit kish dalë Ark. Demetrio Loricchio kujt i ngarkuan projektin ekzekutiv dhe udhëheqjen e punëvet. Vepra, çë ka të mbarohet mbrënda ditëvet të parë të muajit të tetorit 2010, u financua ka Krahina e Kalabrisë (me fonde të Arkës së Depozitavet dhe të Huavet). Shuma në dispozicion për realizimin e punëvet kap 103.510,82 euro, me një zbritje në neto të ankandit të 28,051% të bërë ka ndërmarrja "Miracco G." ka Shën Sofia. Tek rifitimi kanë të hyjnë rivendosja e gjelbërimit përballë shpivet, krijimi i udhëvet për këmbësorët, shtrimi i gjithë sheshit dhe realizimi i instalimit të dritës të jashtëm tek vendi i atij ekzistues tashmë i vjetruar. Gjithashtu parashikohet realizimi i një parkimi për automjete me disa vende të rezervuara për të penguarit; vënia në veprim e bankave druri dhe metali dhe të shportave për mbeturinat. Qarkullimi mbrënda sheshit ka t'i kufizohet vetëm automjetevet çë nëng e shkojnë një peshë të caktuar, sa të ruhet shtrimi i bërë me gurë me shumë vlerë domethënë granit të nxjerrë ka një gërmim çë gjendet tek një katund afër Shën Mitrit.

SHËN SOFI
"Në udhëtim me librin… për një aventurë të re"

Të shtunë 3 llonar, tek Biblioteka Bashkiake "A. Masci", Administrata Bashkiake e Shën Sofisë organizoi një ngjarje sa të promovoni rëndësinë dhe kënaqësinë e leximit, për djemtë e skollës fillore, me titull "Në udhëtim me librin… për një aventurë të re". Projekti e pati si qëllim kryesor promovimin e kënaqësisë së leximit dhe rifitimin e "shijes" për fjalën e diovasur me zë të lartë, tue e propozuar edhe një pamje të re të bibliotekës si një vend për gjithë, burim nxitjesh, mikpritës dhe gazmor. Projekti qe i ndarë në dy takime (menatet dhe pasdite) tek të cilat djemtë, sipas interesit të shprehur, u ndërlikuan tek aktivitete të ndryshme: kërkesë dhe konsultim, domethënë aktivitete çë mund të japin vegla për zbulime të vlefshme në kërkesën dhe konsultimin e materialit bibliografik; lexime, domethënë aktivitete grupi mbi leximet sa të krijohen momente diskutimi, analize dhe meditimi; laboratore, domethënë hapësira pune mbi temat e veçantë e leximevet të përcaktuara ka grupet e pranishme, kështu çë mund të zhvilloheshin momente ndërveprimi, aktivitete krijuese dhe mbështetje e një udhe.

VAKARIC
***Bashki: Vakarici e pati çmimin për riqarkullimin ka* Legambiente**

Bashkia e Vakaricit e pati e pati çmimin te konkursi "Comuni Ricicloni 2010"*, për ndjet rezultatavet të mira të mbledhjes së diferencuar, çë te viti 2009 arriti përqindjen e 66%. E muar çmimin, Romë, kryetari i katundit arbëresh. Ngjarja qe organizuar ka* Ecosportello Rifiuti, *sporteli informativ i Shoqatës* Legambiente *për administratat publike për mbledhjen e diferencuar, me mbrojtjen e Ministrisë për Ambientin dhe Ruajtjen e Territorit dhe të Detit. Administrata e Bashkisë së katundit me origjinë shqiptare ka ndonjë vit çë e nisi një udhë në bazë të normavet europiane. Sa të mirrej pjesë tek lista* "Comuni ricicloni" *duhej të shkohej përqindja e 50% të mbledhjes së diferencuar.*

VACCARIZZO ALBANESE
"Le minoranze etniche religiose e l'Unità d'Italia". Evento di successo culturale

Lunedì 26 luglio a Vaccarizzo Albanese presso Palazzo "N. Marino" si è tenuto il convegno "Le minoranze etniche religiose e l'Unità d'Italia", un evento di successo culturale e di pubblico. Il dibattito è stato coordinato dall'on. Mario Caligiuri, Assessore alla Cultura della Regione Calabria; dopo i saluti del Sindaco di Vaccarizzo Albanese, Aldo Marino, sono intervenuti Maria Francesca Corigliano, Assessore alle Minoranze etnico-linguistiche della Provincia di Cosenza; Gian Antonio Stella, Opinionista del Corriere della Sera, con la relazione sull'importanza degli Arbëreshë nell'Unità d'Italia; Bruno di Porto, Rappresentante della Comunità Ebraica, che ha tracciato un quadro di differenze, somiglianze e analogie tra le minoranze arbëreshe, ebraica e musulmana; papàs Elia Hagi, viceparroco della comunità di Vaccarizzo Albanese, che si è soffermato sul ruolo del clero nell'educazione degli eroi arbëreshë del Risorgimento; Khalid Chaouki, Rappresentante della Comunità Musulmana, che ha parlato dell'integrazione della comunità islamica in Italia. Il dibattito si è concluso con i ringraziamenti del sindaco ai relatori e al pubblico.

VAKARIC
"Pakicat etnike fetare dhe Bashkimi i Italisë " një ngjarje kulturore me sukses

Të hënën 26 llonar Vakaric tek Pëllasi "N. Marino" *u mba diskutimi "Pakicat etnike fetare dhe Bashkimi i Italisë", një ngjarje kultorore pjot me sukses. Bashkërënditi kuvendin i nderuari Mario Caligiuri, Asesor për Kulturën e Krahinës së Kalabrisë; pas përshëndetjevet të Kryetarit të Vakaricit, Aldo Marino, muartin pjesë Maria Francesca Corigliano, Asesor për Pakicat etniko-gjuhësore të Provinçës së Kosenxës; Gian Antonio Stella, Mendimtar i gazetës* Corriere della Sera, *me relacionin mbi rëndësinë e Arbëreshëvet tek Bashkimi i Italisë; Bruno di Porto, Përfaqësues i Komunitetit Hebraik, çë foli për ndryshimet, ngjashmëritë dhe analogjitë ndër pakicat arbëreshe, hebraike dhe myslimane; zoti Elia Hagi, nënfamullitari i Vakaricit, çë u ndalua mbi rolin e klerit për edukimin e heronjvet arbëreshë të Risorxhimento-s; Khalid Chaouki, Përfaqësues i Komunitetit Mysliman çë foli për integrimin e komunitetit islamik në Itali. Diskutimi u mbulli me falënderimet e kryetarit referuesvet dhe publikut.*

SAN DEMETRIO CORONE
Operatori ex fondo sollievo ad Acri

Ancora un'iniziativa molto utile degli operatori dell'ex Fondo Sollievo di San Demetrio Corone. Dopo gli interventi di pulizia eseguiti nel mese di giugno a San Benedetto Ullano, Roggiano Gravina e San Marco Argentano, sei operatori, tre uomini e tre donne, coordinati dal capocantiere Luigi Valente e dall'ingegnere Malagrinò, su richiesta della Comunità Montana Sila Greca, hanno provveduto non solo alla pulizia della sede della comunità sita ad Acri a piazza San Domenico ma anche all'abbellimento del piazzale antistante, curando le aiuole, piantando nuovi fiori e piante. L'intervento è stato molto apprezzato dagli acresi che hanno espresso il loro ringraziamento agli operatori.

SHËN MITËR
Operatorët e ish Fondit Lehtësimi Akër

Njetër nismë shumë e vlefshme qe ajo e operatorëvet të ish Fondit Lehtësimi ka Shën Mitri. Pas ndërhyrjevet pastrimi të bërë tek muaji i theristiut Shën Benedhit, në Roggiano Gravina dhe San Marco Argentano, gjashtë operatorë, tre burra dhe tri gra, të bashkërenditur ka ktyekantieri Luigi Valente dhe ka inxhinieri Malagrinò, me kërkesën e Bashkësisë Malore të Sillës Greke, u kujdestin jo vetëm për pastrimin e selisë së Baskësisë çë gjendet Akër dhe të sheshit San Domenico por edhe për zbukurimin e sheshit përballë, tue u marrë me lehet, dhe tue mbjellë lule dhe bima të rea. Akrjotët e çmuan shumë ndërhyrjen dhe i falënderuan operatorët.

SAN GIORGIO ALBANESE
"S. Giorgio e i suoi Comuni": Assemblea a San Giorgio a Cremano

Si è tenuto lo scorso mese a S. Giorgio a Cremano il Summit 2010 tra i rappresentanti dell'Ass. "S. Giorgio e i suoi Comuni". All'ordine del giorno le processioni dedicate al Santo Patrono che dà il nome a diverse città italiane. Hanno partecipato alla manifestazione i sindaci di S. Giorgio Jonico, S. Giorgio di Mantova, S. Giorgio del Sannio, S. Giorgio di Pesaro, Monforte S. Giorgio, S. Giorgio Morgeto, S. Giorgio di Lomellina, Porto S. Giorgio, S. Giorgio La Molara, S. Giorgio A. Nel corso dell'assemblea è stata nominata presidente onoraria Clara Baracchi, moglie del compianto Gianni Baracchi, fondatore dell'associazione, costituita il 21 settembre 2002 a Porto S. Giorgio. L'associazione ha lo scopo di promuovere e valorizzare il territorio, la cultura e il turismo dei comuni che si richiamano a S. Giorgio.

MBUZAT
"Shën Gjergji dhe Bashkitë të tij": Kuvend në San Giorgio a Cremano

U mba tek muaji çë shkoi në San Giorgio a Cremano Takimi 2010 ndërmjet përfaqësuesve të shoqatës "Shën Gjergji dhe Bashkitë e tij". Te rendi i ditës procesionët për Shenjtorin Mbrojtës çë i jep emrin shumë qyteteve italiane. Muartin pjesë te shfaqja kryetarët e bashkivet pasuese: San Giorgio Jonico, San Giorgio di Mantova, San Giorgio del Sannio, San Giorgio di Pesaro, Monforte San Giorgio, San Giorgio Morgeto, San Giorgio di Lomellina, Porto San Giorgio, San Giorgio La Molara, Mbuzati. Gjatë kuvendit u emërua president nderi Clara Baracchi, e shoqja e të ndjerit Gianni Baracchi, themelues i shoqatës, së krijuar më 21 vjesht 2002 në Porto San Giorgio. Shoqata e ka qëllimin sa të të japë shtysë territorit, kulturës dhe turizmit të bashkivet çë e rikujtojnë Shën Gjergjin.

SAN DEMETRIO CORONE
Inaugurata immagine di Madre Teresa di Calcutta

